

PSH.nr.819/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Goran Milenkovic – Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “EdiBau-ing” SH.P.K. – Prizren, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i objektit të ri shkollor Zef Lush Marku në Velezhë - faza e tretë”, me nr. të prok: “622-20-2647-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prizren, më datë: 13.11.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “EdiBau-ing” SH.P.K. – Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i objektit të ri shkollor Zef Lush Marku në Velezhë - faza e tretë”, me nr. të prok: “622-20-2647-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prizren.

**II. VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i objektit të ri shkollor Zef Lush Marku në Velezhë - faza e tretë”, me nr. të prok: “622-20-2647-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prizren.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e Grupi i operatorëve ekonomik: “EdiBau-ing” SH.P.K. – Prizren, aprovet pjesërisht si e bazuar i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues OE "EdiBau-ing" SH.P.K. – Prizren, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 19.10.2020 me nr. 279/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i objektit të ri shkollor Zef Lush Marku në Velezhë - faza e tretë", me nr. të prok: "622-20-2647-5-2-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prizren, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 27, 52, 59 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 23.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 28.10.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim: Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues, ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse në paramasën nr.32 dhe 46 nuk ka dhënë fare çmim, që bazuar në LPP nuk lejohet që të mos plotësojnë pozicione të caktuara, eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit, gjegjësisht paramasës dhe kërkesave të dosjes, e gjen pretendimin e lartpërmendur si të pabazuar. Arsyetimi i një konstatimi të tillë vijon si më poshtë:

Paramasa e ngarkuar nga Autoriteti Kontraktues, gjegjësisht pozicionet 32 dhe 46 janë dizajnuar të shënohen si nëntituj. Do të thotë, pozicioni 32 tek Pjesa C. Instalimet, shënon: "Furnizimi dhe montimi i gypave të çelikut për ngrohje qëndrore:" duke listuar kështu llojet e gypave të përmendur në pozicionet e radhës (33, 34, 35, 36, etj). E njëjta logjikë e dekompozimit të materialeve të kërkuara përdoret edhe tek pozicioni 46, pjesa C Instalimet ku shënon "Radiatore të çelikut të "Fabrikës së radiatorave" Gjilan ose të ngjajshëm , porositen komplet me mbajtësa, valvolave për ajrosje dhe kapakë horizontal dhe vertikal.", ndërsa tipet e produkteve të lartpërmendura listohen si nënpozicione.

|    |  |      |    |  |  |
|----|--|------|----|--|--|
| 46 | Radiatore të çelikut të "Fabrikës së radiatorave" Gjilan ose të ngjajshëm , porositen komplet me mbajtësa, valvolave për ajrosje dhe kapakë horizontal dhe vertikal. |      |    |  |  |
|    | Tip 22-500x1000  | cope | 2  |  |  |
|    | Tip 22-500x1500  | cope | 2  |  |  |
|    | Tip 22-500x2000  | cope | 7  |  |  |
|    | Tip LUX 500x1000   | cope | 15 |  |  |



As pozicioni 32, as 46 nuk kanë të shënuara njësi të matjes në shabllonin e paramasës së dizajnuar nga Autoriteti Kontraktues, karakteristikë kjo e cila nënkupton që pozicionet e tilla shërbejnë nën cilësinë e përmendur më lartë dhe ndihmojnë në dekompozimin e produkteve të kërkuara.

Vlen të ceket që pozicionet e tilla nuk janë plotësuar në paramasat e tyre të ofertuara as nga OE ankues dhe as nga ai i rekomanduar për kontratë, konform kërkesave dhe përshkrimit të paramasës, dhe si të tilla, mos plotësimi i pozicioneve të lartpërmendura nuk thërret në shpalljen e papërgjegjshme të operatorëve ekonomik pasi që për rastin konkret nuk kemi shkelje të nenit 52 dhe 59 të LPP-së.

Sa i përket pretendimit ankimor në lidhje me përlllogaritjen e saktë të pozicionit me numër 39, Eksperti Shqyrtues konstaton që një çështje e tillë është tashmë e gjykuar – res judicata – në raportin me numër rendor të ankesës 548/20 të datës 04.09.2020. Po ashtu, natyra teknike e pozicionit në fjalë, gjegjësisht përfshirja e llogaritjes së pozicionit si përqindje e vlerës së pozicioneve 34-48 dhe arsyeshmëria teknike e kësaj përfshirjeje dhe jo e materialeve të tjera ndihmëse mbetet nën diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht njësisë kërkuese që të plotësojë dosjen konform nenit 27 të LPP-së.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si të pabazuar, duke sugjeruar kështu që njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i objektit të ri shkollor Zef Lush Marku në Velezhë faza e tretë” me nr. të prokurimit: “622-20-2647-5-2-1”, *aktivitet ky i iniciuar nga AK: KK Prizren*, të mbetet në fuqi. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i AK-së njoftimi për dhënie të kontratës.

Autoriteti Kontraktues nuk është deklaruar se a pajtohet apo nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datë 31.10.2020, me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, duke shtuar:

Në pajtim me dispozitat e nenit 115.1 të LPP, ju përcjellim përgjigjen lidhur me raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues me nr. 819/20 për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të ri shkollor Zef Lush Marku në Velezhë - faza e tretë”, numri i aktivitetit të prokurimit: 622-20-2647-521 me të cilin shprehim kundërshtimet tona lidhur me mendimin dhe rekomandimin e tij, me të cilin rekomandon që ankesa jonë të refuzohet si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi AK për dhënie të kontratës. Ne nuk pajtohemi me këtë

ekspertizë dhe se i njëjti vetëm ka konfirmuar vendimin e AK-Komuna e Prizrenit dhe shtojmë se pozicionet dhe paramasat e DT në veçanti pozicioni 32 dhe 46 janë në kundërshtim me nenin 27 dhe 28 të LPP-ës, se këto pozicione kanë lënë hapsira për të manipuluar dhe kanë vë në lajthitje OE.

Ne kërkojmë nga paneli shqyrtues që të mbajne seancë dëgjimore ku të na ftoj edhe ne, me qëllim të sqarimit të këtyre pikave kontestuese dhe kemi besim që paneli shqyrtues të vendos në mënyrë meritore dhe ankesën tonë t'a aprovoj si të bazuar.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 13.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "EdiBau-ing" SH.P.K. – Prizren, se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse në paramasën nr.32 dhe 46 nuk ka dhënë fare çmim, që bazuar në LPP nuk lejohet që të mos plotësojnë pozicione të caktuara.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se paramasa e ngarkuar nga Autoriteti Kontraktues, gjegjësisht pozicionet 32 dhe 46 janë dizajnuar të shënohen si nëntituj. Do të thotë, pozicioni 32 tek Pjesa C. Instalimet, shënon: "Furnizimi dhe montimi i gypave të çelikut për ngrohje qendrore:" duke listuar kështu llojet e gypave të përmendur në pozicionet e radhës (33, 34, 35, 36, etj). E njëjta logjikë e dekompozimit të materialeve të kërkuara përdoret edhe tek pozicioni 46, pjesa C Instalimet ku shënon "Radiatore të çelikut të "Fabrikës së radiatorave" Gjilan ose të ngjashëm , porositen komplet me mbajtësa, valvolave për ajrosje dhe kapakë horizontal dhe vertikal.", ndërsa tipet e produkteve të lartpërmendura listohen si nënpozicione. Po ashtu, as pozicioni 32, as 46 nuk kanë të shënuara njësi të matjes në shabllonin e paramasës së dizajnuar nga Autoriteti Kontraktues, karakteristike kjo e cila nënkupton që pozicionet e tilla shërbejnë nën cilësinë e përmendur më lartë dhe ndihmojnë në dekompozimin e produkteve të kërkuara. Pozicionet e tilla nuk janë plotësuar në paramasat e tyre të ofertuara as nga OE ankues dhe as nga ai i rekomanduar për kontratë, konform kërkesave dhe përshkrimit të paramasës, dhe si të tilla, mos plotësimi i pozicioneve të lartpërmendura nuk thërret në shpalljen e papërgjegjshme të operatorëve ekonomik pasi që për rastin konkret nuk kemi shkelje të nenit 52 dhe 59 të LPP-së.



Sa i përket pretendimit ankimor në lidhje me përlllogaritjen e saktë të pozicionit me numër 39, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton që një çështje e tillë është tashmë e gjykuar – res judicata sipas ankesës 548/20 të datës 04.09.2020. Po ashtu, natyra teknike e pozicionit në fjalë, gjegjësisht përfshirja e llogaritjes së pozicionit si përqindje e vlerës së pozicioneve 34-48 dhe arsyeshmëria teknike e kësaj përfshirjeje dhe jo e materialeve të tjera ndihmëse mbetet nën diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht njësisë kërkuese që të plotësojë dosjen konform nenit 27 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

**Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK Komuna Prizren;
- 1x1 OE "EdiBau-ing" SH.P.K. – Prizren;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.